

I nderuar President i Dhomës Amerikane të Tregëtisë, Z. Jaço,
I nderuar Drejtor Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregëtisë Z. Trimi,
Të nderuar anëtarë të Dhomës Amerikane të Tregëtisë

Përshëndetje të gjithëve.

Në rradhë të parë dua t'ju falenderoj për këtë traditë të krijuar tashmë në çdo fillim viti, ku ulemi bashkarisht dhe bëjmë një analizë të asaj çfarë kemi bërë mirë vitin që shkoi, çfarë duhet të përmirësojmë dhe çfarë sfidash na presin në vijim.

Ky vit ishte i vështirë për të gjithë, por arritëm të përmbushim detyrat tona në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve.

Ne ishim pjesë e pandarë e zinxhirit të institucioneve të shërbimeve mbështetëse të shtetit në luftën kundër Pandemisë.

Roli aktiv dhe ndihmues i Administratës Doganore siguroi që spitalet të mos përballëshin me vonesa në pajisjet kyçe, që qytetarët të mos ndeshedhin me “rafte bosh” në supermarkete e dyqane, që farmacive të mos u mungonin ilaçet e nevojshme për të luftuar Covid 19. Pavarësisht pandemisë dhe izolimit, shërbimi doganor ishte aktiv 24 orë në 24 në shërbim të biznesit!

Administrata Doganore Shqiptare do të vazhdojë edhe gjatë këtij viti të jetë pjesë e rëndësishme e shërbimeve, e cila me vëmendje të shtuar po mbështet procesin e vaksinimit, ashtu sikundër edhe kontribuam në lehtësimin e procedurave për pajisjet mjekësore, për tamponët dhe vaksinat e gripit.

Prioritetet tona për këtë vit janë:

- Krijim i lehtësirave për biznesin dhe qytetarët nëpërmjet ofrimit të shërbimit në kohë dhe me cilësi, duke shmangur vonesat dhe burokracitë e panevojshme
- Menaxhimi i problematikave të biznesit gjatë krizës Covid19
- Rritje e të ardhurave doganore

Roli i Administratës Doganone është mjaft i rëndësishëm dhe kyç në krijimin e klimës së favorshme për biznesin, ndaj kemi krijuar një sërë lehtësirash për ta:

Regjimi i Magazinave të Lira si rrjedhojë e përafrimit të Kodit Doganor e Dispozitive të tij me legjislacionin doganor të BE, i ka transformuar ato në **Zona të Lira**, ku gjatë vitit 2020 numërojmë 6 të tilla, duke i shtuar lehtësive të ofruara edhe mundësinë e përpunimit pa taksa, por njëkohësisht këto incentiva kanë sjellë dhe rritjen e kapaciteteve mbajtëse **nga 150 milion litra në 500 milion litra** karburante brënda zonave të lira, pra **më shumë se 3 fish**.

Magazinimi Doganor - u mundëson subjekteve lehtësim të procedurave dhe pagesave. Vetëm gjatë vitit 2020 janë dhënë 15 autorizime për regjim të magazinimit doganor. Ndërkohë që gjatë gjithë periudhës 8 vjecare nga 2013 në 2020, janë shtuar 96 magazina doganore.

Përpunimi Aktiv – regjim doganor që lehtëson aktivitetin e përpunimit industrial si dhe nxit punësimin. Janë shtuar **205 operatorë, që i korrespondon një rritje prej 40%** që nga viti 2013 me një total prej 5 352 autorizimesh, nga të cilat 721 i përkasin vetëm vitit 2020.

Magazinat Fiskale – janë shtuar si aktivitetet prodhuese edhe numri i operatorëve të autorizuar me **519 ose afro 136%**, duke ulur ndjeshëm informalitetin dhe prodhimin klandestin. Vlen të përmendet këtu se një pjesë jo pak e rëndësishme e përbëjnë operatorët e peshkarexhave, që nëpërmjet rregjistrimit jo vetëm fiskalizojnë detyrimet, por përfitojnë si incentivë ekonomike përjashtim nga detyrimi për akcizën e karburanteve.

Që nga viti 2013 numërojmë një total prej 5 410 autorizimesh, nga të cilat 899 i përkasin vetëm vitit 2020.

Për regjimet e mësipërme si dhe për procedura të tjera, risi e vitit 2020 ka qënë mundësia e aplikimit online në portalin e-Albania, nëpërmjet të cilit janë realizuar 928 aplikime. Kjo do të thotë që janë kursyer nga operatorët ekonomike 1856 orë ose e thënë ndryshe

232 ditë pune.

Përrjashtimet - Në përmbushje të synimit të qeverisë për mbështetje e biznesit, përfshirë dhe vëmëndjen e shtuar ndaj bujqësisë, administrata doganore ka mundësuar përjashtimet nga TVSH-ja, një incentivë kjo e drejtpërdrejtë në ndihmë të biznesit në vlerën prej **27.83** miliardë lekë gjatë shtatë viteve të kësaj qeverie.

Në këtë periudhë operatorët ekonomikë kanë përfituar nga përjashtimet për TVSH-në e makinerive industriale në vlerën **23** miliardë lekë.

Mbas 2015, politikat e qeverisë në mbështetje të bujqësisë kanë qënë prioritare gjë që shihet edhe në përfitimet nga TVSH-ja për inpute dhe makineri bujqësore në vlerën **4.7** miliardë lekë.

Vlen të theksohet se këto politika nxitëse janë një risi. Ato kanë sjellë përfitime konkrete dhe të prekshme për bujqësinë, që më parë nuk ekzistonin.

Aktualisht objekt i përjashtimeve nga Administrata Doganore janë edhe subjektet e përfshira në rindertimin dhe eleminimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019. Deri me sot vlera e këtyre përjashtimeve nga detyrimet doganore arrin në vlerën 51 milionë lekë.

Pjesë e rëndësishme e lehtësirave për biznesin janë edhe shërbimet online, konkretisht:

- Përmirësimi i aplikimeve on-line për autorizime si dhe rritja e numrit të tyre nëpërmjet portalit e-Albania nga 8 aplikime, të cilat janë aktualisht në 34 aplikime, nëpërmjet përmirësimit dhe krijimit të modulit “Backend”.
- Plotësimi i kushteve për t’ju bashkuar Konventës së Përbashkët të Tranzitit, përmes zhvillimit të Sistemit të Ri të Kompiuterizuar të Tranzitit – platformës NCTS.
- Implementimi i procedurave të thjeshtuara duke përfshirë konceptin e OEA, përmes krijimit të modulit elektronik të OEA (Operatori Ekonomik i Autorizuar) dhe marrja e masave për zhvillimin e kapaciteteve.

- Implementimi i "Korridorit të gjelbër" edhe me vendet e BE për mallrat e listës prioritare.
- Implementimi i masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë me fokus trajtimin e problematikave të Operatorëve Ekonomikë.
- Ndjekja e Projektit Single Ëindoë.

Objektiv tjetër i rëndësishëm për administratën tonë, sic e përmendëm edhe më lart, është rritja e të ardhurave doganore.

Gjatë periudhës 2013-2019 shënohet një rritje e të ardhurave me 18%, nga të cilat:

- ✓ **Të ardhura nga taksa doganore, rritur me 12%**
- ✓ **Të ardhura nga akciza, rritur me 28%**
- ✓ **Të ardhura nga TVSH, rritur me 22%**

Arsyet kryesore të kësaj performance vijnë nga:

- ✓ Formalizimi i ekonomisë
- ✓ Lufta kundër kontrabandës dhe evazionit fiskal
- ✓ Ndërgjegjësimi i operatoreve ekonomike

Efekt të rëndësishëm në këtë performancë kanë patur edhe reformat e ndërmarra nga vetë administrata doganore, sic mund të përmendim krijimin e Drejtorisë së Vlerës në Qendër, që ka mundësuar unifikim dhe trajtim të barabartë në fushën e vlerësimit doganor; informatizim i vazhdueshëm i procedurave doganore si ristrukturimi dhe rekrutimet e reja të administratës doganore nga studentët e ekselencës.

Në fushën e vlerësimit doganor, për një temë mjaft sensibil në vite për anëtarët e Dhomës Amerikane të Tregëtisë në lidhje me aplikimin e të dhënave të disponueshme (Referencave) do dëshiroj t'ju informoj që aktualisht: Gjatë vitit 2020 përdorimi i referencave (duke u zhveshur nga mallrat e bursës dhe automjetet që përdoren nga individët) ka qënë në masën 3%.

Ulja e kohës së zhdoganimit, përbën një tjetër celës të suksesit të arritjes së këtyre performancave, pasi kjo ul kostot e biznesit dhe redukton kohën e qëndrimit në zyrat doganore. Konkretisht

nga 144 min/deklaratë që ka qënë mesatarja e përpunimit të deklarateve në vitin 2018, tashmë kjo shifër është reduktuar në 99 min/deklaratë, pra është reduktuar me 31%.

Në kuadër të **Integrimit drejt BE** dhe bashkëpunimit me ndërkombëtarët, Dogana Shqiptare merr pjesë aktive në veprimtaritë rajonale, evropiane e me gjërë. Gjithashtu në kuadër të luftës kundër trafikëve ajo merr pjesë në operacione të përbashkëta me OBD, Interpol, Europol.

Në bashkëpunimin me anëtarët e Dhomës Amerikane të Tregëtisë, Dogana Shqiptare ka një histori të gjatë bashkëpunimi të frytshëm. Sigurisht nuk kemi realizuar gjithcka, por zyrat tona, konkretisht Unë dhe gjithë stafi im, jemi të hapur dhe në dispozicionin tuaj për çdo nevojë!

Mirëpresim dhe do të trajtojmë me seriozitetin maksimal çdo sugjerim tuajin për përmirësim brenda kuadrit ligjor dhe detyrave që ligji i ngarkon administratës doganore.

Këtu sëbashku me mua është dhe stafi drejtues teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me qëllim sqarimin teknik të çdo problematike të ngritur apo që mund të dalë gjatë diskutimeve.

Faleminderit